



Analizë e Votimit nga Jashtë për  
**Zgjedhjet Lokale në Republikën e Kosovës**

# **VOTIMI NGA JASHTË DIASPORA 2021**



Prishtinë, 2022



Të drejtat e autorit © 2022. GERMIN  
Të gjitha të drejtat e rezervuara.

Përveç citimeve të shkurtra për qëllim të kritikës dhe rishikimit, asnjë pjesë e këtij publikimi nuk mund të riprodhohet, të ruhet në ndonjë sistem të të dhënave ose të transmetohet në çfarëdo forme apo mjete elektronik, fotokopjues, ose tjetër, pa lejen paraprake të autorit.

Përmbajtja e këtij botimi është përgjegjësi e Organizatës GERMIN.

## **Lista e akronimeve:**

AAK - Aleanca për Ardhmërinë e Kosovës

BSH - Bashkë për Shtërpcën

IQGD - Iniciativa Qytetare Green për Drenas

IQM - Iniciativa qytetare "Mitrovica"

KATP - Kosova Adalet Turk Partisi

KDTP - Kosova Demokratik Turk Partisi

KQZ - Komisioni Qendror i Zgjedhjeve

LDK - Lidhja Demokratike e Kosovës

LVV - Lëvizja VETËVENDOSJE!

NISMA - Nisma Socialdemokrate

NJ - Narodno Jedinstvo

PDK - Partia Demokratike e Kosovës

PSD - Partia Socialdemokrate

PSHDK - Partia Shqiptare Demokristiane e Kosovës

PZAP - Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtesa

QNR - Qendra e Numërimit dhe Rezultateve

QTP - Qendra Tranzite Postare

SKQZ - Sekretariati I Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

VAKAT - Koalicija Vakati

## **PËRMBAJTIJA:**

<b>HYRJE</b>	<b>1</b>
<b>Korniza Ligjore</b>	<b>2</b>
<b>E Drejta e Votës nga Jashtë Vendit</b>	<b>3</b>
E drejta për të votuar dhe Procedura e Votimit	
<b>Vota e diasporës - Zgjedhjet lokale 2021 në Republikën e Kosovës</b>	<b>4</b>
Procesi i Regjistrimit dhe Votimit në Zgjedhjet Lokale të 17 tetorit 2021	
Numri i Aplikuesve ( të aprovuar dhe Refuzuar)	
Numri i aplikacioneve të pranuar nga KQZ sipas shteteve	
Numri i Aplikacioneve të Pranuar sipas Komunave	
Rezultatet e Verifikimit nga Thirrjet Telefonike	
Procesi i Votimit	
Vlerësimi i pakove me fletëvotime	
<b>Të dhëna nga procesi i verifikimit dhe numri total i votave</b>	<b>19</b>
<b>Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të komunave 2021</b>	<b>24</b>
Dërgimi i Pakove me Fletëvotime	
Procesi i vlerësimit	
Arsyet e refuzimit	
<b>Problemet gjatë periudhës së regjistrimit dhe cenimi i të drejtës së votës</b>	<b>29</b>
<b>Konkluzionet</b>	<b>30</b>
<b>Rekomandimet</b>	<b>31</b>
<b>Bibliografia</b>	<b>33</b>

## HYRJE

Shtetasit e Republikës së Kosovës që jetojnë jashtë vendit kanë të drejtë të zgjedhin dhe të zgjidhen njësoj sikurse të gjithë të tjerët që jetojnë në Kosovë. Republika e Kosovës përmes Kushtetutës dhe legjislacionit të saj mundëson ushtrimin e të drejtave zgjedhore për të gjithë qytetarët pa dallim, pavarësisht vendit ku ata jetojnë. Të drejtat zgjedhore hyjnë në kuadrin e të drejtave themelore dhe garantohen me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe Ligjet në fuqi por edhe me dokumente/konventa ndërkombëtare. Në Kosovë votimi nga jashtë vendit lejohet për të gjitha llojet e zgjedhjeve. Qytetarët jo-rezident mund të votojnë përmes postës në Zgjedhjet Lokale apo Qendrore, pasi të jenë regjistruar suksesshëm për votim pranë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ). Mirëpo, edhe pse ekziston një numër i madh i qytetarëve që jetojnë jashtë vendit dhe interesimi për të votuar nga jashtë është rritur ndër vite, procesi i pjesëmarrjes së tyre në Zgjedhje në Kosovë vazhdon të jetë i ndërlikuar, i përcjellur me probleme të përsëritura, të cilat pengojnë pjesëmarrjen në zgjedhje si dhe ndikojnë në uljen e besueshmërisë karshi institucioneve. Pavarësisht vlerësimeve pozitive për ecurinë e zgjedhjeve brenda vendit, votimi nga jashtë vazhdon të mbetet problematik. Problemet me regjistrimin, dërgimin dhe pranimin e zarfeve me fletëvotime nga jashtë si dhe mungesa e informimit dhe edukimit të duhur të votuesve, kanë përcjellë pothuajse çdo cikël zgjedhor, përfshirë edhe atë të Zgjedhjeve Lokale, raundi i parë i të cilave u mbajt me 17 tetor 2021 ndërsa raundi i dytë me 14 nëntor 2021. Kjo analizë paraqet një përmbledhje të këtij procesi, përfshirë pengesat gjatë procesit të votimit nga jashtë dhe ofron një pasqyrë të detajuar të të gjitha operacioneve zgjedhore në kuadër të tij. Analiza paraqet të dhënat dhe rezultatet e votimit nga jashtë gjatë zgjedhjeve të fundit për zgjedhjet lokale të vitit 2021, duke përfshirë kështu rundin e parë dhe të dytë (balotazhit).

## Korniza Ligjore

Legjislacioni në fuqi i Republikës së Kosovës në lidhje me votimin nga jashtë ka për bazë statusin e personave që jetojnë jashtë vendit. Fillimisht, Kushtetuta e Republikës së Kosovës në nenin 45 paragrafi 1 ka përcaktuar se “Çdo shtetas i Republikës së Kosovës që ka arritur moshën tetëmbëdhjetë vjeç, qoftë edhe ditën e zgjedhjeve, gëzon të drejtën të zgjedhë dhe të zgjedhet, me përjashtim kur kjo e drejtë i kufizohet me vendim gjyqësor”. Ndërsa neni 45 paragrafi 3 ka përcaktuar se “Institucionet shtetërore mbështesin mundësitë për pjesëmarrjen e çdonjërit në aktivitete publike dhe të drejtën e secilit për të ndikuar në mënyrë demokratike në vendimet e demokratike në vendimet e organeve publike. Gjithashtu, rëndësi i kushtohet kualifikimit të personave si qytetarë që jetojnë jashtë vendit apo pjesëtarët e diasporës. Sipas Nenit 2 të Ligjit 04/L-215 për Shtetësinë, pjesëtar i Diasporës është “çdo person që e ka qëndrimin e ligjshëm jashtë Republikës së Kosovës i cili dëshmon se ka lindur në Republikën e

<sup>1</sup> Ligji për Zgjedhjet e Përgjishme 03/L-073. Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2008. <https://gzk.rks.gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>

Kosovës,<sup>1</sup> pjesëtar i diasporës konsiderohet edhe secili person i cili është pasardhës brenda një gjenerate i personit që ka lindur në Republikën e Kosovës”. Përveç këtyre, e drejta e ushtrimit të votës nga jashtë vendit specifikohet edhe në Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet e Përgjithshme, Ligjin nr. 03/L-073 për Zgjedhjet Lokale si dhe Rregulloret e Komisionit Qendror Zgjedhor.

Në bazë të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme dhe Ligjit për Zgjedhjet Lokale, të drejtë aplikimi kanë të gjithë ata/ato që: kanë mbushur tetëmbëdhjetë (18) vjet në ditën kur mbahen zgjedhjet dhe e plotëson njërin prej kriterëve vijuese:

- Është i regjistruar si qytetar i Kosovës në Regjistrin Civil.
- Banon jashtë Kosovës në, apo pas 1 janarit 1998.
- Ka fituar statusin e refugjatit në, apo pas 1 janarit 1995, dhe ka të drejtë për t’u regjistruar në Regjistrin Qendror Civil si banor i Kosovës.

Në anën tjetër, asnjë person nuk mund të votojnë nëse:

- Është duke vuajtur dënimin e shqiptuar nga Tribunali Penal Ndërkombëtar për ish-Jugosllavinë.
- Është i akuzuar nga Tribunali, dhe ka dështuar t’i bindet urdhrorit për t’u paraqitur para Tribunalit.
- Është shpallur mentalisht i paaftë me vendim të prerë gjyqësor.



## **E Drejta e Votës nga Jashtë Vendit**

Votimi nga qytetarët jo-rezident tanimë në Kosovë është bërë një tipar i rëndësishëm i politikës bashkëkohore. Është mëse e dukshme që sot në një botë të globalizuar, me flukse të mëdha të migrimit është nxitur debat rreth votimit nga jashtë.

Votimi nga jashtë, quhet shkak i procedurës së votimit për personat të cilët jetojnë përkohësisht apo përgjithmonë jashtë vendit, që kanë të drejt të ushtrojnë të drejtat e tyre të votës jashtë territorit të vendit amë. Votimi nga jashtë tregon shumë lidhur me demokracinë brenda një vendi. Vetë pjesëmarrja në zgjedhjeve, u jep mundësinë qytetarëve nga jashtë të kontribuojnë, si në anën politike në lidhje me zhvillimet në vendin amë, e po ashtu edhe ndikimi në zgjedhjet e tyre sipas analizave të tyre, të krijuara nga vendet se ku jetojnë. Përveç kësaj votimi nga jashtë është një tipar tjetër që ndikon në mbajtjen e lidhjeve dhe marrëdhënieve të ngushta me vendin e tyre të origjinës, duke i krijuar ndjenjën e përkatësisë së vendit amë.

### **E drejta për të votuar dhe Procedura e Votimit**

Për të ushtruar të drejtën e votës, shtetasit e Kosovës të cilët jetojnë jashtë vendit duhet të ndjekin disa procedura dhe afate kohore për të cilat merren vendime në KQZ, kjo gjithmonë në përputhje me ligjet në fuqi dhe rregulloret përkatëse. Si procedurë e votimit nga jashtë, qytetari duhet që të aplikojë në formularin për regjistrim të paraqitur nga KQZ si dhe ta plotësojë me sukses brenda afatit të përcaktuar. Bazuar në rregulloret e KQZ, afati mundet të zgjasë deri në 40 ditë gjatë zgjedhjeve të rregullta, kurse në të jashtëzakonshme mundë të shkurtohet deri në 7 ditë.

Në këtë rast pas shqyrtimit të aplikacioneve nga KQZ, përcaktohet e drejta e aplikuesve për votim, pra atyre që iu miratohet aftësia për të votuar, atëherë munden ta dërgojnë votën e tyre me postë në një zarf apo pako që brenda përmban zarfin tjetër me fletëvotim. Në një pako mund të ketë më shumë se sa një zarf me fletëvotim, që do të thotë se anëtarët e ngushtë të një familje të cilët kanë të njëjtin mbiemër mund të dërgojnë zarfet e tyre me anë të një pako të vetme. Deri më tani votimi lejohet vetëm përmes postës për kundër që GERMIN, ka ndërmarrë iniciativa të ndryshme që të krijohen mundësitë e votimit edhe në konsullata, gjë që do të lehtësonte dukshëm procesin.

## **Vota e diasporës - Zgjedhjet lokale 2021 në Republikën e Kosovës**

Qëllimi i kësaj analize është të kontribuojë në rritjen e rëndësisë dhe pjesëmarrjes së diasporës në proceset zgjedhore në Republikën e Kosovës. Analiza kryesisht është e ndërtuar me hulumtimet e aspekteve ligjore si dhe monitorimin e cikleve të zgjedhjeve lokale.



Ndërsa si objektiva ka të paraqesë një pasqyrë të procesit të votimit dhe rekomandimet të cilat dalin nga kjo analizë. Është tashmë e ditur që interesi i diasporës për të marrë pjesë në procese zgjedhore është duke u rritur, kjo është parë kryesisht nga zgjedhjet parlamentare të viti 2021. Po ashtu edhe në këto zgjedhje lokale nëse e krahasojmë me zgjedhjet lokale të vitit 2017 interesimi për të votuar është rritur bazuar me aplikimet për të votuar, ku në vitin 2017 kishte rreth 11 mijë aplikime kurse në këto zgjedhje ishin mbi 18 mijë.

Zgjedhjet lokale të 17 tetorit 2021, janë zgjedhjet lokale të 8-tat me radhë të cilat janë mbajtur në Republikën e Kosovës në aspekt të Kuvendeve të Komunave, si dhe të 16-tat për Kryetar të Komunave, përfshirë këtu edhe zgjedhjet e jashtëzakonshme të cilat janë organizuar në komuna të caktuara ndër vite. Për një vend si Kosova, përfshirja e diasporës në proceset zgjedhore është e rëndësishme, kjo sidomos për mbajtjen e lidhjeve me qytetarët jashtë vendit. Kosova konsiderohet si një shtet me diasporë të madhe sidomos kur e shikojmë në proporcion me numrin e përgjithshëm të qytetarëve vendas. Andaj votimi i tyre në Kosovë është shumë i rëndësishëm që të shihet pikëpamja dhe analiza e tyre për kandidatët të cilët futen në këtë garë për të udhëhequr një komunë përkatëse si dhe për kandidatët të cilët synojnë të jetë pjesë e kuvendeve të komunave.

## Procesi i Regjistrimit dhe Votimit në Zgjedhjet Lokale të 17 tetorit 2021

Në kuadër të votimit nga jashtë të zgjedhjeve lokale të 17 tetorit 2021, periudha e aplikimit për regjistrim për votim jashtë vendit filloi nga data 10 korrik deri me 18 gusht 2021. Gjatë kësaj periudhe, shtetasit e Kosovës me të drejtë vote që jetojnë jashtë Republikës së Kosovës kanë aplikuar për regjistrim për të votuar përmes postës.

Meqë zgjedhjet e 17 tetorit ishin të rregullta, procesi i regjistrimit sa i përket aspektit kohor ka qenë i mjaftueshëm, ku hapësira kohore ka lejuar që çdo i/e interesuar të ketë mundësinë të regjistrohet, koha e regjistrimit ishte nga 10 korrik deri 18 gusht. E njëjta vlen edhe për aspektin e efikasitetit të stafit të KQZ-së në shqyrtimin e të gjitha aplikacioneve të dërguara.

Meqë zgjedhjet e 17 tetorit ishin të rregullta, procesi i regjistrimit sa i përket aspektit kohor ka qenë i mjaftushëm, ku hapësira kohore ka lejuar që çdo i/e interesuar të ketë mundësinë të regjistrohet, koha e regjistrimit ishte nga 10 korrik deri 18 gusht. E njëjta vlen edhe për aspektin e efikasitetit të stafit të KQZ në shqyrtimin e të gjitha aplikacioneve të dërguara.

Në periudhën e Aplikimit për Regjistrim për Votim jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale 2021, e cila ka filluar me datën 10 korrik 2021 dhe ka përfunduar me datën 18 gusht 2021, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, ka pranuar gjithsejtë: 18,836 aplikacione për regjistrim.

Nga 18,836 aplikacione për regjistrim të pranuar gjithsejtë:

- 147 aplikacione për regjistrim janë pranuar në kutinë postare, përmes postës, dhe
- 18,689 aplikacione janë pranuar përmes e-mailit (ovpp@kqz-ks.org, vjk.kqz@kqz-ks.org, dhe ogpp@kqz-ks.org).

Këto statistike ju përfshijnë numrin e aplikuesve që janë aprovuar pas procesit të ankesave në Panelin Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës.

## Numri i Aplikuesve ( të Aprovuar dhe Refuzuar)

Gjatë kësaj periudhe kohore konkretisht nga 10 korrik deri 18 gusht KQZ pranoi 18,836 aplikacione në sistem që në krahasim me zgjedhjet lokale të vitit 2017, ka një rritje prej 7000 aplikimeve më shumë.

Nga 18,836 aplikime, të regjistruara me sukses ishin 15,577, kjo pasi që 3,259 u cilësuan si të pasuksesshme si rezultat i mos përmbushjes së kushteve ligjore si dhe duplikimit gjatë aplikimit. Më shumë se gjysma e tyre janë refuzuar pasi të dhënat e tyre nuk përkuan me kërkesat e aplikacionit si dhe kishte mungesë të informacioneve të nevojshme për regjistrim.

Nga 15,577 aplikacione të aprovuara për regjistrim, 14,429 aplikues të aprovuar suksesshëm ishin shtetas të Republikës së Kosovës. Ndërsa, 1,148 aplikues të aprovuar suksesshëm nuk ishin shtetas të Republikës së Kosovës, që do të thotë se janë qytetarë të cilët kanë lindur në shtetet perëndimore dhe nuk kanë nën-shtetësi të vendit amë.

Numri më i madh i aplikimeve të aprovuara për regjistrim ishte nga Gjermania, duke vijuar më pas me apalikimet nga Zvicra, Belgjika, ShBA, vende këto ku diaspora e Kosovës janë dukshëm më të shtrirë në krahasim më vendet e tjera.

<sup>2</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve, Shërbimi për Votuesit Jashtë Vendit.  
<https://www.kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/>

<sup>3</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Zgjedhjet Lokale 2021 - Raport Përfundimtar - Periudha e Aplikimit për Regjistrim për Votim jashtë Kosovës.

Tabela 1: Kategoritë sipas refuzimit të aplikacioneve <sup>4</sup>

<b>TË DHËNA PËR KATEGORITË E REFUZIMIT</b>	<b>NR. I APLIKACIONEVE TË REFUZUARA</b>
<b>Kodi i refuzimit “2”:</b> Mos plotësimi i kriterëve juridike.	1,351
<b>Kodi i refuzimit “3”:</b> Aplikuesit nën moshën 18 vjeç (në ditën e zgjedhjeve, 17 tetor 2021 nuk i mbushin 18 vjeç).	8
<b>Kodi i refuzimit “4”:</b> Aplikacione që nuk janë konfirmuar pas thirrjeve telefonike, si shkak e-mail adresat të dyshimta.	1,172
<b>Kodi i refuzimit “5”:</b> Aplikuesit që kanë hequr dorë nga shtetësia e Republikës së Kosovës.	255
<b>Kodi i refuzimit “6”:</b> Aplikacionet e pranuar në kutinë postare, që nuk kanë përmbajtur vulën dhe pullën postare të postës dërguese.	101
<b>Kodi i refuzimit “7”:</b> Aplikacione të dërguara jashtë rrethit të ngushtë familjarë, nga një e-mail adresë	352
<b>Kodi i refuzimit “8”:</b> Aplikacionet e verifikuara përmes telefonit, ku aplikuesit kanë konfirmuar se nuk kanë aplikuar personalisht.	81
<b>TOTALI:</b>	<b>3,320</b>

### Numri i aplikacioneve të pranuar nga KQZ sipas shteteve

Në tabelën e më poshtme janë të paraqitura aplikacionet për të drejtë vote sipas shteteve. Përmes kësaj analizohet edhe pjesa e shtrirjes së shumicës së diasporës tonë.

<sup>4</sup> Komisioni Qendor i Zgjedhjeve, Certifikimi i Rezultateve të Zgjedhjeve Lokale 2021. <https://www.kqz-ks.org/lajmet/kqz-certifikon-rezultatet-perfunditmare-te-zgjedhjeve-per-38-kuvendet-komunale-2/>

Tabela 2: Numri i aplikacioneve të pranuar për shtete

SHTETI	NUMRI I APLIKACIONEVE TË PRANUARA
Gjermani	6688
Zvicër	5528
Mali i Zi	1373
Austri	1021
Itali	1002
Francë	569
Suedi	488
Slloveni	468
Belgjikë	334
Mbretëri e Bashkuar	205
SHBA	196
Norvegji	140
Finlandë	127
Maqedoni e Veriut	112
Turqi	106
Kroaci	80
Kanada	59
Holandë	57
Danimarkë	56
Luksemburg	45
Republika Çeke	36
Bosnja dhe Hercegovina	33
Australi	28
Serbi	20

Tabela 2: Numri i aplikacioneve të pranuar për shtete

Hungari	19
Mongolia	9
Shqipëri	8
Spanjë	6
Islandë	5
Rumani	4
Irlandë	3
Sllovaki	3
Poloni	3
Israel	2
Litejnshtajn	2
Portugali	2
Bahrein	2
Qipro	2
Emiratet e Bashkuara Arabe	2
Skoci	2
Bullgari	1
Greçi	1
Kazakistan	1
Panama	1
Katar	1
Siri	1
Japoni	1
<b>TOTALI:</b>	<b>18,852</b>

Tabela nr 3. Numri i aplikacioneve të aprovuara për shtete

SHTETI	NUMRI APLIKACIONEVE TË PRANUARA
Gjermani	5785
Zvicër	4955
Austri	916
Itali	891
Francë	517
Suedi	425
Slloveni	419
Belgjikë	288
Mbretëri e Bashkuar	186
SHBA	167
Mali i Zi	166
Norvegji	117
Maqedoni e Veriut	109
Turqi	95
Finlandë	85
Kroaci	77
Danimarkë	54
Kanada	53
Holandë	41
Luksemburg	40
Republika Çeke	36
Bosnja dhe Hercegovina	29
Australi	28
Serbi	20

Tabela nr 3. Numri i aplikacioneve të aprovuara për shtete

Hungari	19
Mongolia	9
Shqipëri	8
Spanjë	6
Islandë	5
Rumani	4
Irlandë	3
Sllovaki	3
Poloni	3
Emiratet e Bashkuara Arabe	2
Litejnshtajn	2
Skoci	2
Israel	2
Bullgari	1
Bahrein	1
Qipro	1
Greçi	1
Kazakistan	1
Panama	1
Portugali	1
Katar	1
Siri	1
Japoni	1
<b>TOTALI:</b>	<b>15,577</b>

## Numri i Aplikacioneve të Pranuara sipas Komunave

Në tabelën e më poshtme janë të paraqitura aplikacionet e aprovuara sipas komunave, që njëherit përveçse tregojnë interesin e qytetarëve për të votuar sipas prejardhjes së tyre në aspektin e komunave, po ashtu tregojnë edhe mbi të dhënat e migrimit sipas komunave:

Tabela nr 4. Numri i aplikacioneve të aprovuara sipas komunave të Republikës së Kosovës.

KOMUNA	NUMRI I APLIKACIONEVE TË APROVUARA
Suharekë	1859
Dragash	1094
Gjakovë	1088
Juniku	1051
Pejë	930
Prizren	923
Deçan	817
Viti	753
Istog	707
Malishevë	702
Prishtinë	666
Gjilan	607
Ferizaj	522
Kamenicë	442
Klinë	437
Rahovec	383
Podujevë	336
Skenderaj	324



Tabela nr 4. Numri i aplikacioneve të aprovuara sipas komunave të Republikës së Kosovës.

Lipjan	308
Mitrovicë e Jugut	272
Mamushë	245
Glllogoc	175
Vushtrri	174
Kaçanik	165
Fushë Kosovë	135
Shtime	116
Novobërdë	94
Hani i Elezit	86
Obiliq	60
Zubin Potok	54
Shtërpcë	20
Graçanicë	11
Klllokot	10
Mitrovica Veriore	8
Zveçan	2
Ranillug	1
<b>Gjithsej:</b>	<b>15,577</b>

## Rezultatet e Verifikimit nga Thirrjet Telefonike

Për tridhjetë e një (31) komuna, gjithsej numri i aplikacioneve të verifikuara përmes thirrjeve telefonike ishte 312 aplikacione.

Rezultatet e verifikimit nga aplikuesit që janë telefonuar, ishin si në vijim:

- 88 persona kishin konfirmuar se kanë aplikuar personalisht (28.21%).
- 13 persona kishin konfirmuar se nuk kanë aplikuar personalisht (4.16%).
- 211 persona janë telefonuar tri herë, por nuk i janë përgjigjur thirrjeve ose shërbimi telefonik është përgjigjur me arsyen se rrjeti ishte i ngarkuar (67.63%).<sup>5</sup>

## Procesi i Votimit

Pas shpalljes së listës së votuesve nga jashtë, KQZ ka përcaktuar afatin për dërgimin e fletëvotimeve nga jashtë për zgjedhjet lokale. Procesi i telefonimit ishte ndryshe në krahasim me zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit 2021, ku janë konfirmuar një nga një të gjithë aplikuesit, gjë të cilën ne si GERMIN e kemi kundërshtuar, ndërkohë që ka pasur shumë reagime nga shoqëria civile në Kosovë dhe shumë organizata në diasporë të cilat bënë thirrje për hedhjen poshtë të këtij vendimi kufizues.

Gjatë periudhës së dërgimit të zarfeve me fletëvotime konkretisht nga 15 shtator - 15 tetor, kanë arritur 5,649 pako me fletëvotime. Këto pako me fletëvotime kanë arritur përmes disa postave, si: Posta e Kosovës, DHL, UPS dhe TNT numri i të cilave është më poshtë i detajuara në tabelë:

Tabela nr.5. Pakot e arritura në posta.

Posta	Numri i pakove
Posta 6, kutia postare 351	5524
DHL Express Kosovë	102
TNT	15
UPs	8
<b>Gjithsej</b>	<b>5649</b>

<sup>5</sup> Po aty.

Të gjitha këto pako të arritura, fillimisht janë dërguar në objektin e ish-Gërmisë, kati i 3-të. Nga fillimi i ardhjes së pakove të para e deri me datën 15 tetor kanë qëndruar në po të njëjtën hapësirë, të cilat u monitoruan nga të gjithë të interesuarit të cilët ishin të akredituar në cilësinë e vëzhguesve pranë KQZ, kështu duke përfshirë subjektet politike, organizatat e shoqërisë civile dhe përfaqësues të mediave. Padyshim që pjesë e monitorimit të vazhdueshëm ishin edhe Policia e Republikës së Kosovës, ku qasja dhe përkushtimi i punës së tyre siguronte dhe tregonte shumë mbi rëndësinë e ruajtjes së votës së diasporës.

Verifikimi i pakove me fletëvotime është bërë në po të njëjtin objekt, ku pastaj është bërë bartja e këtyre pakove të verifikuara për numërim në QNR, ku procesi i monitorimit nga organizatat e shoqërisë civile, subjekteve politike dhe mediave ka qenë i vazhdueshëm. E njëjta procedurë është aplikuar edhe në periudhën e balotazhit.

### Vlerësimi i pakove me fletëvotime

Me datën 17 tetor 2021 ka filluar vlerësimin e pakove me fletëvotime.

Vlerësimi i pakove me fletëvotime bëhet me qëllim të identifikimit të fletëvotimeve me personat që kanë dërguar pakon, për të verifikuar, se:


- Personat që kanë dërguar pakot me fletëvotim, janë votues në listën e votuesve jashtë Kosovës (që janë aprovuar në periudhën e aplikimit për regjistrim), ose
- Personat që kanë dërguar pakot me fletëvotim, janë refuzuar në periudhën e aplikimit për regjistrim, ose
- Personat që kanë dërguar pakot me fletëvotim, nuk kanë aplikuar në periudhën e aplikimit për regjistrim, etj.

Tabela nr.6. Numri i pakove të proceduara dhe vlerësuara

Numri total i pakove të proceduara/ vlerësuara si të individualizuara	10,900
Numri i pakove të aprovuar (fletëvotime në kuti të votimit)	9,576
Numri i pakove të refuzuara	1,324

Tabela nr.7. Arsyet dhe numri i pakove të refuzuara në rundin e parë

Kodet e refuzimit	Arsyet e refuzimit	Numri i fletëvotimeve të refuzuara
D1	Personat që nuk kanë aplikuar në periudhën e aplikimit për regjistrim	614
D2	Aplikuesit e refuzuar gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim	200
D4	Personat që kanë dërguar pako me fletëvotime më shumë se një herë	168
D5	Personat që nuk janë identifikuar të cilët kanë dërguar vetëm fletëvotim (nuk kanë dërguar kopje të dokumenteve identifikuese)	82
D6	Personat që kanë dërguar fletëvotimet me kopje të dokumenteve identifikuese me afat të skaduar	68
D7	Pako me fletëvotime të dërguara jashtë rrethit të ngushtë familjarë	178
D8	Pako me fletëvotime që nuk kanë përmbajtur vulën dhe pullën postare të postës dërguese	14
<b>TOTALI</b>		<b>1,324</b>



Në tabelat e mëposhtme janë të paraqitura të dhënat lidhur me aprovimet e fletëvotimeve të kategorizuara për shtete si dhe për komunat në Republikën e Kosovës.

**Tabela 8: Numri i pakove me fletëvotime të aprovuara për komunat e Republikës së Kosovës.**

SHTETI	Nr. i fletëvotimeve të aprovuara
Gjermani	3626
Zvicër	3322
Austri	639
Itali	448
Slloveni	277
Francë	265
Suedi	233
Belgjikë	179
Maqedoni e Veriut	101
Mbretëri e Bashkuar	65
SHBA	60
Kroaci	52
Norvegji	52
Turqi	44
Danimarkë	43
Bosnja dhe Hercegovina	27
Republika Çeke	26
Kanada	21
Luksemburg	18
Holandë	17
Australi	15

Tabela 8: Numri i pakove me fletëvotime të aprovuara për komunat e Republikës së Kosovës.

Mali i Zi	9
Hungari	9
Finlandë	5
Serbi	4
SHBA	2
Poloni	2
Mongoli	2
Islandë	2
Panama	1
Greqi	1
Japoni	1
Katar	1
Skoci	1
Sllovaki	1
Spanjë	1
Bahrein	1
Irlandë	1
Shqipëri	1
Portugali	1
<b>Totali:</b>	<b>9,576</b>

Tabela 9: Numri i pakove me fletëvotime të aprovuara për komunat e Republikës së Kosovës.

KODI KOMUNAL	KOMUNA	NR. I APLIKACIONEVE TË APROVUARA
01	Deçan	453
02	Gjakovë	720
03	Glllogoc	107
04	Gjilan	348
05	Dragash	679
06	Istog	426
07	Kaçanik	95
08	Klinë	240
09	Fushë Kosovë	80
10	Kamenicë	273
11	Mitrovicë e Jugut	133
13	Lipjan	181
14	Novobërdë	78
15	Obiliq	35
16	Rahovec	236
17	Pejë	493
18	Podujevë	201
19	Prishtinë	326
20	Prizren	532
21	Skenderaj	122
22	Shtime	76
23	Shtërpcë	13
24	Suharekë	1277

Tabela 9: Numri i pakove me fletëvotime të aprovuara për komunat e Republikës së Kosovës.

25	Ferizaj	305
26	Viti	541
27	Vushtrri	87
28	Zubin Potok	444
30	Malishevë	443
31	Juniku	842
32	Mamushë	109
33	Hani i Elezit	73
37	Kllokot	6
38	Mitrovicë e Veriut	2
<b>TOTALI:</b>		<b>9,576</b>

### Të dhëna nga procesi i verifikimit dhe numri total i votave

Procesi i verifikimit të pakove me fletëvotime ka filluar me datën 17 tetor 2021 dhe ka mbaruar me 19 tetor 2021. Pas verifikimit dhe numërimit të votave me postë, është marrë vendim nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve që periudha për përsëritjen e votimit përmes postës për rundin e dytë të zgjedhjeve për kryetar të Komunës së Dragashit të fillojë më 29 nëntor dhe të përfundojë më 13 dhjetor, kjo për shkak të dyshimeve për manipulim të votave përmes postës. Këtë të drejtë për të votuar përmes postës e kanë pasur vetëm votuesit të cilët janë regjistruar si votues jashtë Kosovës gjatë periudhës 10 korrik – 18 gusht 2021. Numri i votuesve jashtë Kosovës për Komunën e Dragashit ishte 1,090.

Vota e diasporës, ishte vendimtare në shumë komuna, qoftë në fitoren pa balotazh e po ashtu edhe dërgimin në balotazh të disa komunave të cilat përmes votave qytetare nga brenda Kosovës vetëm se ishin afër të kalonin pa balotazh. Rast për tu theksuar është Komuna e Fushë Kosovës, e cila me votat e diasporës u dërgua në balotazh duke tregu kështu rëndësinë e votës së diasporës. Poashtu rast tjetër është komuna e Dragashit dhe Junikut në të cilat u vendos kryesisht nga votat e diaspora.

<sup>6</sup>Vendimi i Gjykatës Supreme rreth Votave nga Jashtë në Komunën e Dragashit.  
<https://koha.net/kosove/298485/supremja-vendos-per-rivotim-te-diaspores-nga-dragashi/>



Komuna e Dragashit shkoi në ri-votim të votës me postë e cila fillojë më 29 nëntor dhe përfundojë më 13 dhjetor e ku të drejtën për të votuar e kishin 1,090 qytetarë që ishin të regjistruar suksesshëm gjatë aplikimit në periudhën 10 korrik - 18 gusht 2021.<sup>6</sup>

Tabela nr 10. Votat e Diasporës për kryetar komunash në rundin e parë

Komuna	Subjekti Politik	Numri i votave	Totali i votave
Deçan	AAK	235	428
	LDK	153	
	LVV	35	
	Të tjera	5	
Gjakovë	LVV	289	711
	AAK	178	
	PSHDK	128	
	Të tjera	116	
Glllogovc	LVV	39	100
	PDK	36	
	IQGD	21	
	Të tjera	4	
Gjilan	LVV	199	324
	LDK	99	
	PDK	20	
	Të tjera	6	
Dragash	LDK	359	669
	Vakat	157	
	PDK	77	
	Të tjera	76	
Shtime	LVV	66	75
	LDK	5	
	PDK	4	
Shtërpçë	BpSH	11	13
	LVV	2	
Suharekë	LDK	711	1226
	AAK	307	
	LVV	147	
	Të tjera	61	

Tabela nr 10. Votat e Diasporës për kryetar komunash në rundin e parë

Istog	LDK	231	412
	LVV	83	
	AAK	70	
	Të tjera	28	
Kaçanik	LVV	56	96
	LDK	17	
	Shukri Luta	13	
	Të tjera	10	
Klinë	AAK	140	235
	LVV	36	
	LDK	35	
	Të tjera	24	
Fushë Kosovë	LVV	49	75
	LDK	13	
	PDK	11	
	Të tjera	2	
Kamenicë	LVV	168	265
	PSD	63	
	LDK	12	
	Të tjera	22	
Mitrovicë e Jugut	LVV	69	128
	PDK	40	
	LDK	19	
Lipjan	LDK	95	171
	LVV	69	
	PDK	7	
Ferizaj	LVV	141	280
	PDK	81	
	LDK	31	
	Të tjera	27	
Vitia	PDK	289	527
	LDK	122	
	LVV	116	
Hani i Elezit	PDK	53	72
	REFKI SUMA	16	
	LVV	3	

Tabela nr 10. Votat e Diasporës për kryetar komunash në rundin e parë

Novobërdë	LDK	70	75
	LVV	5	
Obiliq	LVV	22	33
	IQB	8	
	LDK	3	
Rahovec	AAK	91	223
	LDK	74	
	LVV	48	
	Të tjera	10	
Pejë	LDK	331	457
	LVV	71	
	AAK	55	
Podujevë	LVV	161	194
	LDK	25	
	AAK	8	
Prishtinë	LVV	231	318
	LDK	52	
	PDK	23	
	Të tjera	12	
Prizren	LVV	202	512
	PDK	171	
	LDK	106	
	Të tjera	33	
Skenderaj	PDK	87	113
	KP-Bekim Jashari	26	
Vushtrri	LVV	37	80
	LDK	33	
	PDK	10	
Malishevë	LVV	183	415
	LDK	121	
	PDK	57	
	Të tjera	54	
Klllokot	NJ	4	4

Tabela nr 10. Votat e Diasporës për kryetar komunash në rundin e parë

Novobërdë	LDK	70	75
	LVV	5	
Obiliq	LVV	22	33
	IQB	8	
	LDK	3	
Rahovec	AAK	91	223
	LDK	74	
	LVV	48	
	Të tjera	10	
Pejë	LDK	331	457
	LVV	71	
	AAK	55	
Podujevë	LVV	161	194
	LDK	25	
	AAK	8	
Prishtinë	LVV	231	318
	LDK	52	
	PDK	23	
	Të tjera	12	
Prizren	LVV	202	512
	PDK	171	
	LDK	106	
	Të tjera	33	
Skenderaj	PDK	87	113
	KP-Bekim Jashari	26	
Junik	LDK	446	843
	AAK	332	
	LVV	61	
	Të tjera	4	
Mamushë	KDTP	55	108
	ILYAS BAYRAKTAR	33	
	KATP	20	
Mitrovicë e Veriut	IQM	1	1

## Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të komunave 2021

Bazuar në rezultatet e KQZ-së, së paku në 19 komuna janë shënuar fitore të partive politike që në rundin e parë ndërsa, 18 komuna tjera shkuan në rundin e dytë të zgjedhjeve lokale që do të mbahen që u mbajtën me 14 nëntor. Në këtë rund të dytë ndikim të madh pati vota e diasporës në disa komuna si Juniku, Mamusha, dhe Dragashi e cila shkoj në ri-votim tek votat me postë. Ky ri-votim u bë si shkas i disa ankesave nga PDK, e cila dërgoj në gjykatë padinë për votat e diasporës, si dyshim që të gjitha ato zarfe ishin të shkruara me të njëjtin shkrim.

Vlerësimi i pakove me fletëvotime, ka filluar në ditën e zgjedhjeve, me datën 14 nëntor 2021 dhe ka përfunduar po me këtë datë.

Pas vlerësimit të pakove me fletëvotime, është bërë klasifikimi i pakove në kuti të votimit sipas komunave të Republikës së Kosovës.

### Dërgimi i Pakove me Fletëvotime

Para periudhës së votimit përmes postës Divizioni i Shërbimit të Votuesve, i ka dërguar fletëvotimet përmes e-mailit tek të gjithë votuesit, të cilët për gjatë përgjat periudhës së regjistrimit kanë aplikuar suksesshëm për regjistrim për votim jashtë vendit.

Njoftimi e dërguara<sup>7</sup>përmes e-mailit, kanë përmbajtur:

- Udhëzimin se si votohet, dhe
- Fletëvotimet për kryetar të komunave

Nga data 29 tetor 2021 deri me datën 12 nëntor 2021, KQZ-ja ka pranuar gjithsejtë: 1,571 pako të supozuara me fletëvotime.

Fletëvotimet janë pranuar nga posta nr. 6, ku KQZ ka kutinë postare, si dhe nga postat tjera të shpejta, si: DHL dhe TNT.


Tabela nr.11. Numri i pakove të proceduara dhe vlerësuara në rundin e dytë

Numri total i pakove të proceduara/ vlerësuara si të individualizuara	2,658
Numri i pakove të aprovuar (fletëvotime në kuti të votimit)	2,379
Numri i pakove të refuzuara	279

<sup>7</sup> Numri i votuesve të cilët kanë aplikuar suksesshëm për regjistrim për votim jashtë Kosovës për Zgjedhjet Lokale 2021 për njëzet e një (21) komunat në rundin e dytë të zgjedhjeve është: 10,228, <https://www.kqz-ks.org/lajmet/kqz-certifikon-rezultatet-perfundimtare-te-raundit-te-dyte-te-zgjedhjeve-lokale-per-kryetare-te-18-komunave/>

Tabela nr.12. Arsyet dhe numri i pakove të refuzuara në rundin e dytë

Kodet e refuzimit	Arsyet e refuzimit	Numri i fletëvotimeve që janë refuzuar
D1	Personat që nuk kanë aplikuar në periudhën e aplikimit për regjistrim	129
D2	Aplikuesit e refuzuar gjatë periudhës së aplikimit për regjistrim	23
D4	Personat që kanë dërguar pako me fletëvotime më shumë se një herë	91
D5	Personat që nuk janë identifikuar të cilët kanë dërguar vetëm fletëvotim (nuk kanë dërguar kopje të dokumenteve identifikuese)	15
D6	Personat që kanë dërguar fletëvotimet me kopje të dokumenteve identifikuese me afat të skaduar	21
	<b>TOTALI</b>	<b>279</b>



Në tabelat e mëposhtme janë të paraqitura statistikat lidhur me numrin e fletëvotimeve të aprovuara sipas shteteve dhe sipas komunave, në kuadër të raundit të dytë të zgjedhjeve:

Tabela 13: Numri i pakove me fletëvotime të aprovuara për shtete.<sup>8</sup>

SHTETI	NUMRI I ZARFEVE TË APROVUARA
Zvicër	1117
Gjermani	594
Austri	331
Suedi	82
Turqi	57
Francë	57
Belgjikë	25
Itali	20
Slloveni	17
Danimarkë	16
Mbretëri e Bashkuar	13
Norvegji	11
SHBA	9
Maqedoni e Veriut	6
Kanada	6
Holandë	6
Australi	4
Finlandë	3
Republika Çeke	2
Katar	1
Kroaci	1
Spanjë	1
<b>TOTALI</b>	<b>2,379</b>

<sup>8</sup> Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. Raport Përfundimtar - Vlerësimi i fletëvotime nga jashtë Kosovës Raundi i dytë i zgjedhjeve për kryetar të komunave 2021

Tabela 14: Numri i pakove me fletëvotime të aprovuara për komunat e Republikës së Kosovës

KODI KOMUNAL	KOMUNA	NR. I FLETËVOTIMEVE TË APROVUARA
02	Gjakovë	168
03	Glllogoc	5
04	Gjilan	214
05	Dragash	308
06	Istog	72
07	Kaçanik	23
08	Klinë	22
09	Fushë Kosovë	40
10	Kamenicë	148
16	Rahovec	56
18	Podujevë	101
19	Prishtinë	143
20	Prizren	124
22	Shtime	57
26	Viti	60
27	Vushtrri	11
30	Malishevë	56
31	Juniku	670
32	Mamushë	101
	<b>TOTALI</b>	<b>2,379</b>



Më poshtë është paraqitur tabela në kuadër të së cilës janë të paraqitura votat e diasporës në rundin e dytë.

Tabela nr 15. Votat e diasporës për kryetar komunash në balotazh

Komuna	Subjekti Politik	Numri i votave	Total vota
Gjakovë	LVV	82	156
	AAK	74	
Glllogovc	DD	4	5
	PDK	1	
Gjilan	LVV	148	213
	LDK	65	
Istog	LDK	48	70
	AAK	22	
Kaçanik	LVV	19	21
	PDK	2	
Klinë	AAK	19	22
	PDK	3	
Fushë Kosovë	LVV	34	40
	LDK	6	
Kamenicë	LVV	108	145
	PSD	37	
Rahovec	LVV	43	56
	AAK	13	
Podujevë	LVV	91	102
	LDK	11	
Prishtinë	LVV	122	137
	LDK	15	
Prizren	LVV	68	121
	PDK	53	
Shtime	LVV	42	56
	PDK	14	
Vitia	LVV	33	57
	LDK	24	
Vushtrri	LDK	4	5
	PDK	1	

Tabela nr 15. Votat e diasporës për kryetar komunash në balotazh

Malishevë	PDK	56	57
	NISMA	1	
Junik	LDK	436	668
	AAK	232	
Mamushë	KATP	28	55
	KDTP	27	

## Problemet gjatë periudhës së regjistrimit dhe cenimi i të drejtës së votës

Marrë parasysh që zgjedhjet ishin të rregullta, periudha kohore ka qenë e mjaftueshme për tu përgatitur në lidhje me procesin e votimit. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve në përpunje me ligjet në fuqi, vendosi një periudhë 40 ditore për të drejt aplikimi për regjistrim për të votuar, konkretisht nga data 10 korrik deri në 18 gusht 2021. Gjatë kësaj kohe qytetarët nga jashtë Republikës së Kosovës duhet të aplikojnë për t'u regjistruar si votues nga jashtë. Pas regjistrimit të qytetarëve nga jashtë, KQZ telefoni çdo të pestin aplikues bazuar në vendimin e kaluar të OSBE, si dhe ndryshe nga vendimi i marrë në zgjedhjet parlamentare të 14 shkurtit, ku janë telefonuar të gjithë ata/ato që kanë aplikuar, kjo në mënyrë që të konfirmohet se a janë po ata persona që janë regjistruar.

Përveç kësaj, vlen të theksohet edhe mungesa e informimit të mjaftueshëm nga KQZ për mënyrën se si duhej regjistruar, ku ka pasur shumë qytetarë që nuk kanë aplikuar me sukses, e të cilët kanë kërkuar mënyra të ndryshme për të shfaqur pakënaqësinë e tyre, kjo po ashtu edhe përmes GERMIN.

Më poshtë janë të paraqitura të gjitha të dhënat në lidhje me telefonimin e aplikantëve:

Bazuar në Udhëzimin Administrativ Nr. 02/ 2021 për verifikimin e aplikacioneve për regjistrim për votim jashtë Kosovës, Sekretariati i KQZ-së obligohej që sipas përzgjedhjes së rastësishme, të verifikonte 2% të aplikacioneve të aprovuara. Metoda e përzgjedhjes është bërë duke tërhequr sipas rastësisë, nga dhjetë (10) aplikacione për regjistrim nga aplikacionet e aprovuara, që janë të arkivuara sipas komunave, për tridhjetë e një (31) komuna të Republikës së Kosovës.

9

<sup>9</sup> Aplikacionet e verifikuara për komunat: Deçan, Gjakovë, Gllogoc, Gjiilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Malishevë, Junik, Mamushë, Hani i Elezit dhe Kllokot.

## Konkluzionet

E drejta për të votuar në zgjedhjet demokratike është vet thelbi i demokracisë brenda një vendi. Natyrisht që edhe motivimi dhe e drejta e votës nga jashtë vetëm se e forcon këtë të drejtë politike. Kjo vetëm se vërehet në situatën në të cilën gjendet Republika e Kosovës, ku ndikimi i diasporës është shumë i dukshëm jo vetëm në aspektin ekonomik, me remitancat që luajnë një rol esencial në stabilitetin socio-ekonomik që ka Kosova mirëpo edhe në aspektin politik, përmes ndikimit në procesin zgjedhor me votë. Lidhur me këtë të fundit është vërejtur interes i shtuar i diasporës gjatë viteve të fundit, kjo sidomos nga numri i madh i aplikuesve për të votuar nga jashtë vendit, specifikisht në zgjedhjet parlamentare të 14 shkurt 2021. Ndikimi dhe interesi është parë edhe në zgjedhjet lokale 2021, ku numri i aplikuesve në krahasim me zgjedhjet paraprake të vitit 2017 është 7,000 aplikues më shumë.

Në krahasim me zgjedhjet lokale të 2017, në këto zgjedhje përveç që interesi ka qenë më i madh edhe procesi i votimit nga jashtë ka kaluar më mirë dhe ka qenë më transparent. Vlen të theksohet se kësaj radhe, përjashtimisht rastit të Komunës së Drafashit, nuk janë vërejtur manipulime apo tendenca të tilla.

Në kuptim të ndikimit politik në rezultate, ajo çfarë karakterizon këto zgjedhje janë balotazhet në të cilat është vërejtur pesha e votës së diasporës, ku komunat të cilat janë llogaritur që përmbyllen direkt në raundin e parë, janë ndikuar nga votat e qytetarëve nga jashtë dhe janë dërguar në raundin e dytë, si shembull komuna e Fushë Kosovës.<sup>10</sup> Përveç dërgimit në balotazh ndikimi tjetër që kishte vota e diasporës ishte rezultati final në Komunën e Dragashit, të cilën e ndryshoi tërësisht nga votat e votuesve brenda Kosovës. Votat nga Diaspora në këtë komunë u kontestuan, arsye me të cilën kundër kandidati nga radhët e PDK depozitoi ankesë tek PZAP, e pastaj edhe tek Gjykata Supreme ku kjo e fundit vendosi që ta dërgoj në ri-votim komunën e Dragashit vetëm për votat me postë. Rezultati final, gjithsesi, nxori fitues LDK, e cila pa votat e diasporës nuk do të mund të fitonte garën.

## Rekomandimet

Çështja e votës së diasporës vazhdon të jetë çdoherë e më shumë në diskutim, kjo jo vetëm në aspektin të drejtës së votës, mirëpo edhe për procesin nëpër të cilin kalojnë bashkatdhetarët tanë për të votuar në vendin amë. GERMIN ka avokuar në vazhdimësi që procesi i votimit të lehtësohet, duke përfshirë rekomandimet e mëposhtme:

<sup>10</sup> <https://kallxo.com/lajm/publikohen-votat-e-diaspores-per-fushe-kosoven/>.

<sup>11</sup> <https://telegرافي.com/rivotimi-permes-postes-ne-dragash-keto-jane-rregullat-qe-duhet-te-ndiqni/>

## **1. ZHVILLIMI I NJË PLATFORME ELEKTRONIKE PËR APLIKIM PËR REGJISTRIM NË UEB-FAQEN E KQZ-SË**

Formave aktuale të aplikimit për regjistrim si votues nga jashtë vendi, rekomandohet t'u shtohet edhe një platformë elektronike në uebfaqen e KQZ-së, e cila do të mundësonte aplikimin online për regjistrim (web-based). Një platformë e tillë do të: (1) lehtësonte dhe thjeshtësonte në krahasim me formën aktuale manuale duke qenë se nuk do të kishte nevojë për printim/plotësim të formularit; (2) zvogëlonte mundësitë e gabimeve në futjen e të dhënave, duke qenë se ajo mund të konfigurohet që të mos pranojë të dhënat e gabuara dhe aplikuesit do të mund të korrigjonin të dhënat e tyre; (3) mënjanonte mbingarkesën e e-mailit zyrtar të KQZ-së, i cili ka qenë problem në zgjedhjet e kaluara. Votimi elektronik nga diaspora do të ishte i shpejtë dhe efikas. Sidoqoftë, teknologjia informative, infrastruktura dhe masat përcjellëse të sigurisë paraqesin sfida serioze për zbatim të suksesshëm.

## **2. VOTIMI VETËM ME DOKUMENTE TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS**

Për të eliminuar çfarëdo dyshimi apo manipulim të mundshëm, vetëm dokumentet valide të Republikës së Kosovës duhet të pranohen si të vlefshme nga KQZ për votim jashtë vendit. Edhe kjo çështje është paraparë të ndryshohet me ndryshimin e Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme. Gjithsesi, kjo duhet të realizohet duke vënë në lëvizje edhe Ministrinë e Punëve të Brendshme si dhe Administratën Publike (MPBAP), pasi siç e kemi cekur më lart, mungesa e posedimit të dokumenteve valide të Republikës së Kosovës nga pjesëtarët e diasporës apo votuesit potencial nga jashtë është një nga pengesat në pjesëmarrjen në zgjedhje. Por, ky duhet të jetë kriter kushtëzues për pjesëmarrje në zgjedhje, pasi që personat që duan të gëzojnë të drejtën e votës duhet të dëshmojnë besnikëri (lojalitet) edhe formale ndaj shtetit të Kosovës.

## **3. DËRGIMI I POSTËS NË AMBASADA DHE KONSULLATA TË REPUBLIKËS**

Zgjerimi i mundësive për votim për pjesëtarët e diasporës duhet të përfshijë edhe mundësinë e dërgimit me postë në ambasadat dhe konsullatat e Kosovës në vendin rezident të qytetarëve jashtë vendit. Duhet të krijohet mundësia që vota me postë të dërgohet në misionin diplomatik/konsullor në të njëjtin shtet, krahas mundësisë për dërgimin e postës në adresë të KQZ-së. Votat përmes postës arrijnë shumë më shpejtë brenda territorit të një shteti. Ndërsa të njëjtat, misioni diplomatik apo konsullor mund t'i dërgojë me postë diplomatike në adresë të KQZ-së. Kështu zgjerohen mundësitë e votimit dhe përshpejtohet procesi.

## **4. TE (RI)SHQYRTOHET ÇËSHTJA E VOTIMIT NGA JASHTË NË ZGJEDHJET LOKALE**

Në procesin e ndryshimit të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme, përkatësisht pjesës së votimit nga jashtë, të (ri)shqyrtohet e drejta e votimit nga jashtë në

zgjedhjet lokale. Votimi i qytetarëve në zgjedhjet lokale kërkon gjithashtu një nivel të caktuar të njohurive dhe lidhjes me komunën përkatëse, prandaj është e rëndësishme të shqyrtohen modalitetet dhe praktikat më të mira në mënyrë që pjesëmarrja e diasporës në zgjedhjet lokale të ndikoj në mënyrë kualitative në zhvillimet politike në komunat e Kosovës.

## Bibliografia

1. Analizë e votimit nga jashtë vendit- Zgjedhjet për Kuvendin e Kosovës - 14 shkurt 2021. Germin, 2021. <https://germin.org/wp-content/uploads/2021/07/Raporti-i-Votes.pdf>
2. Periudha për rivotim të diasporës nga Dragashi fillon më 29 nëntor. Koha.net, 25 nëntor 2021. <https://www.koha.net/kosove/298485/supremja-ven-dos-per-rivotim-te-diaspores-nga-dragashi/>
3. Komisioni Qendror i Zgjedhjeve - Aplikacionet e verifikuara për komunat: Deçan, Gjakovë, Gllogoc, Gjilan, Dragash, Istog, Kaçanik, Klinë, Fushë Kosovë, Kamenicë, Mitrovicë e Jugut, Lipjan, Novobërdë, Obiliq, Rahovec, Pejë, Podujevë, Prishtinë, Prizren, Skenderaj, Shtime, Suharekë, Ferizaj, Viti, Vushtrri, Zubin Potok, Malishevë, Junik, Mamushë, Hani i Elezit dhe Kllokot. <https://www.kqz-ks.org/>
4. Shërbimi i votuesve- Votimi përmes postes, Komisioni Qendror i Zgjedhjeve. <https://www.kqz-ks.org/sherbimet-per-votuesit/votimi-me-poste/>
5. Ligji për Zgjedhjet e Përgjithshme, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDocumentDetail.aspx?ActID=2544>
6. Ligji për Zgjedhjet Lokale, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës <https://gzk.rks-gov.net/ActDetail.aspx?ActID=2549>

